

Cilësia e jetës tek gratë shtatzëna brenda qytetit të Gjakovës

Berisha Ariana¹; Paice Leonora¹; Hoxha Ilir¹

Kolegji Heimerer¹

Hyrje: Cilësia e jetës është shfaqur si një komponent thelbësorë shëndetësor që zgjeron shqetësimet rreth shëndetit të popullatës në përgjithësi, e sidomos tek gratë shtatzëna të cilat janë mjaft të prekura dhe të ndjeshme në aspektet fizike, emocionale, e disa edhe depresiv (Neau, Texier, 2009). Rëndësia e infermierit për nga ana e përmirësimit dhe këshillimit rreth shëndetit tek gratë shtatzëna është mjaft e madhe dhe me shumë përgjegjësi.. Cilësia e jetës ndryshon për njerëz të ndryshëm në situata të ndryshme dhe lidhet me vetë-kënaqësinë me jetën. Cilësia e jetës ndikohet nga gjendja shëndetësore. Shtatzënia është një proces që krijon ndryshime të rëndësishme anatomike, fiziologjike dhe biokomike në jetën e një gruaje. Këto ndryshime ndikojnë në sjelljet fizike dhe emocionale të grave dhe në këtë mënyrë mund të çojë në zvogëlimin e cilësisë së jetës lidhur me shëndetin e tyre. Shtatzënia është një ngjarje emocionale dhe e kënaqshme, megjithatë ajo mund të çojë në çrregullime të ndryshme siç janë, çrregullime gjumi, nauze apo të përziera, lodhje, dobësi, të vjella, etj. (Bromberger, Harlow, 2004).

Metodologjia: Pjesë e këtij hulumtimi janë 90 gra shtatzëna të qytetit të Gjakovës. Instrumenti i përdorur për këtë hulumtim është pyetësi për cilësinë e jetës "Mc Gill" i cili ka 17 pyetje dhe ndahet në 3 pjesë. - Pjesa e parë e pyetësit flet për të dhënat demografike si dhe mbi simptomat dhe problemet fizike gjatë dy ditëve të fundit. Pjesa e dytë e pyetësit flet për gjendjen emocionale të tyre gjatë dy ditëve të fundit. Tek pjesa e tretë ato kanë pasur mundësinë të shkruajnë më gjerësisht se çfarë ka pasur ndikim pozitiv gjatë dy ditëve të fundit para plotësimit të pyetësit.

Rezultatet: 73.5% e grave të anketuara deklarojnë se cilësia e jetës së tyre është e shkëlqyeshme, kurse 26.5% deklarojnë cilësinë e jetës së tyre si shumë të keqe. Si simptoma problematike më të shpeshta ishin "lodhja", "dobësia" dhe "probleme me gjumin". 43.4% e të anketuarave kanë deklaruar që gjatë këtyre dy ditëve janë ndierë fizikisht mirë, dhe 56.6% deklarojnë që janë ndjerë jo edhe aq mirë fizikisht. Pastaj, 48.9% e të anketuarave thonë që nuk ishin shumë nervoze ose të shqetësuara, kurse 51.1% thonë që gjatë kësaj kohe ishin shumë nervoze dhe të shqetësuara.

Konkluzionet: Me realizimin e këtij hulumtimi arrijmë në përfundim se cilësia e jetës tek gratë në qytetin e Gjakovës është mjaftë e mirë. Simptomat më të shprehura janë lodhja, dobësia dhe probleme me gjumin. Depresioni nuk është shumë i pranishëm tek këto gra. Shtatzënia ndikon në shëndetin fizik. Frika është e pranishme kur e mendojnë se çfarë do u sjellë e ardhmja. Kohën gjatë shtatzënisë e konsiderojnë si dhuratë. Përkrahja është gjëja më e nevojshme për to.

Fjalet kyce: Cilësia e jetës, gratë shtatzëna, shtatzënia, kujdesi...